



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2019:163377

Datë: 18.02.2021

Numri i dokumentit: 01517882

**P.nr.1017/20**

### NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtarja e vetme gjykuese Arjeta Gashi, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Afërdita Kicaj, në çështjen penale kundër të akuzuarit A.T., nga Prizreni, për shkak të veprës penale në bashkëkryerje shmangia nga tatimi nga neni 307 paragrafi 1. Lidhur me nenin 31 ë Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK)-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren - Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr. 1516-5/19 të datës 06.11.2020 pas mbajtjes së shqyrtimit mbi marrëveshjen e pranimit të fajësisë, në prezencën e Prokurorit të Shtetit Besim Susuri, të akuzuarit A.T. dhe mbrojtësit av. B.M., me datën 09.02.2021, mori dhe shpalli publikisht, ndërsa me datën 18.02.2021 përpiloi këtë:

### A K T G J Y K I M

#### I akuzuari:

**A.T.**, nga i ati A., e ëma L. e gjinisë T.i lindur me datë ..., në Prizren me banim në rrugën“ ....” nr....., bashkëpronar i biznesit TPharm Aspirin C, i martuar, baba i dy fëmijëve, me profesion ekonomist, i gjendjes së mirë ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i pajisur me numër personal të identifikimit ....., të lëshuar nga MPB-ja e Republikës së Kosovës.

### Ë S H T Ë F A J T O R

I. Se prej datës së pavërtetuar e deri më datën 16.04.2019, i pandehuri në bashkëpunim me tani të ndjerin R.T., me qëllim të fshehjes apo të shmangies pjesërisht apo edhe tërësisht pagesës së tatimit, kontributeve që kërkohen me ligj, si bashkëpronar të biznesit „T-Pharm-AspirinC japin të dhëna të pavërteta ose edhe nuk i përfshinë të dhënat lidhur me të ardhurat si bashkëpronar të biznesit apo edhe ofrojnë informata false lidhur me vlerësimin e detyrimeve tatimore me çka të dëmtuarës Administratës Tatimore (ATK) i shkaktojnë dëm të konsiderueshëm material.

**Me këto veprime në bashkëkryerje ka kryer veprën penale, shmangie nga tatimi nga neni 307 par.1. lidhur me nenin31 të Kodit nr. 06/1-074 Penal të Republikës së Kosovës (KPRK)-së.**

Andaj, gjykata në kuptim të dispozitave të nenit 7, 8, 9, 10, 17, 22, 38, 39, 40, 42, 43, 70, 71, 72 dhe 72 paragrafi 1 pika1.6 të KPRK-së dhe nenit 248 dhe 365 të KPPRK-së, të akuzuarit i shqipton

## **DËNIMIN ME GJOBË**

Në shumën prej 500,00 (pesëqind) euro.

## **DËNIMIN ME BURG**

Në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj.

-Në kuptim të nenit 44 të KPRK-së me kërkesë të mbrojtësit dhe të akuzuarit dënimi me burgim prej 6 (gjashtë) muajve i zëvendësohet me dënim me gjobë në shumën prej 1.000,00 (njëmijë) euro, të cilën dënim me gjobë, në bazë të nenit 43.par.2 të KPK-së, është i obliguar ta paguaj në afat prej 15 ditëve pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse i akuzuari nuk mund apo nuk dëshiron ta paguajë dënimin me gjobë në shumën prej 1.500,00 (njëmijepesëqind) euro, atëherë gjykata konform nenit 43. par.3. të KPRK-së, do t'ia zëvendësoj me dënim me burgim, ashtu që për çdo 20 (njëzet) € llogaritet 1 (një) ditë burgim, gjithsej 75 ditë burgim.

E dëmtuara Administrata Tatimore e Kosovës (ATK), përfaqësuesin ligjor me seli në Prizren, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil.

I akuzuari, obligohet që në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej 20 euro, në emër të ekspertit financiar shumën prej 40.88 euro, si dhe në emër të programit për kompensimin e viktimave të paguaj shumën prej 30 euro, që të gjitha në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

## **A r s y e t i m**

Prokuroria e Shtetit në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm, pranë kësaj gjykate ka parashtruar aktakuzën PP/II.nr. 1516-5/2019 të datës 06.11.2020, kundër të akuzuarit A.T. nga Prizreni, për shkak të veprës penale në bashkëkryerje shmangia nga tatimi nga neni 307 paragrafi 1, lidhur me nenin 31 ë Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK)-së, si dhe marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë, të datës 13.08.2020.

Gjykata duke vepruar në këtë çështje penale ka caktuar dhe mbajtur seancën dëgjimore për shqyrtimin e marrëveshjes për pranimin e fajësisë PP/II.nr. 1516-5/2019 të datës 06.11.2020.

Gjatë seancës dëgjimore së shqyrtimit të marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë gjykata ka dëgjuar të akuzuarin, mbrojtësin e tij, si dhe prokurorin e shtetit.

Sa i përket gjendjes faktike konsiderohet se ajo është vërtetuar plotësisht si në përshkrimin faktik të aktakuzës nën kushtet dhe rrethanat ligjore të marrëveshjes për pranimin e fajësisë.

Prokurori i shtetit gjatë seancës dëgjimore ka ngelur në tërësi pranë marrëveshjes së arritur në mes palëve në procedurë, duke shtuar se marrëveshja është në harmoni të plotë me

dispozitat ligjore të KPPRK-së, duke i propozuar gjykatës që të njëjtën ta aprovoj dhe të akuzuarit, ia shqiptoj dënimin e rekomanduar si në marrëveshje.

Mbrojtësi i të akuzuarit A.T. av. B.M., ka konsideruar se pajtohet me marrëveshjen e arritur në Prokurorin Themelore në Prizren, konsideron se marrëveshja mbi pranimin e fajësisë është nënshkruar konform dispozitave ligjore të KPP-së, andaj i propozon gjykatës të aprovojë marrëveshjen PP/Inr.1516-5/19 të datës 13.08.2020.

I akuzuari A.T. është pajtuar me fjalët e mbrojtësit të tij, dhe mbetet pranë dënimit të rekomanduar si në marrëveshje.

Gjykata gjatë seancës për shqyrtimin e marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë dhe provave materiale në shkresat e lëndës, ka vërtetuar këtë gjendje faktike: se prej datës së pavërtetuar e deri më datën 16.04.2019, i pandehuri në bashkëpunim me tani të ndjerin R.T.me qëllim të fshehjes apo të shmangies pjesërisht apo edhe tërësisht pagesës së tatimit, kontributeve që kërkohen me ligj, si bashkëpronar të biznesit „T-Pharm-AspirinC japin të dhëna të pavërteta ose edhe nuk i përfshinë të dhënat lidhur me të ardhurat si bashkëpronar të biznesit apo edhe ofrojnë informata false lidhur me vlerësimin e detyrimeve tatimore me çka të dëmtuarës Administratës Tatimore (ATK) i shkaktojnë dëm të konsiderueshëm material, me këto veprime në bashkëkryerje ka kryer veprën penale, shmangie nga tatimi nga neni 307 par.1. lidhur me nenin 31 të Kodit nr. 06/1-074 Penal të Republikës së Kosovës (KPRK)-së.

Sipas detyrës zyrtare, gjykata konform nenit 257 të KPPRK-së, nuk gjeti se ekziston ndonjë prove e pa pranueshme sipas ligjit. Gjykata gjithashtu vlerësoj se nuk ekzistojnë rrethana të përcaktuara nga neni 253 të KPPRK-së, të cilat do të konsistonin në krijimin e situatës dhe rrethanave për hedhjen e aktakuzës.

Gjykata pas dëgjimit të pikëpamjeve të prokurorit të shtetit, të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij, lidhur me pranimin e fajësisë sipas marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë konstatoi se i akuzuari, ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i akuzuari pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tij, i akuzuari nuk ka qenë i detyruar ose i shtrënguar në asnjë mënyrë të pranoj fajësinë, pranimi i fajësisë mbështetet në faktet dhe prova materiale të rastit konkret të cilat paraqiten në aktakuzë të pranuar edhe nga i akuzuari.

Gjatë seancës për caktimin e dënimit prokurori i shtetit ka mbetur pranë dënimit të rekomanduar si në marrëveshje.

Mbrojtësi i të akuzuarit, po ashtu ka mbetur pranë dënimit të rekomanduar si në marrëveshje.

I akuzuari në tërësi është pajtuar me fjalët e mbrojtësit të tij.

Gjykata nga të cekurat më lartë ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet qenësore të veprës penale të përshkruar si në shqiptimin e këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarin ta shpall fajtor dhe ta gjykoj në bazë të ligjit e më parë duke e vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

Gjatë marrjes së vendimit mbi llojin dhe lartësinë e dënimit gjykata ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parapara në nenin 69 dhe 70 të KPRK-së të cilat ndikojnë

në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit. Prej rrethanave lehtësuese për të akuzuarin A.T. gjykata ka vlerësuar: pranimi i fajësisë, pendimi për kryerjen e veprës penale. Andaj duke mos gjetur asnjë rrethanë të veçantë rënduese e cila do të ndikonte në llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata ka aprovuar marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë në tërësi në të gjitha pikat e saj, me ç'rast të akuzuarin e shpalli fajtor dhe i shqiptoj dënimin e rekomanduar, Kështu që gjykata ka ardhur në përfundim se me dënimin e shqiptuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi do të arrihet qëllimi i dënimit sipas nenit 41 të KP-së dhe se dënimi i tillë i shqiptuar, sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me peshën e veprës penale të kryer dhe me rrethanat personale të të akuzuarit, me bindjen se i akuzuari në të ardhmen të jetë më i përgjegjshëm dhe të përmbahet nga veprimet e këtilla.

Vendimi për realizimin e kërkesës pasurore juridike, është marrë konform nenit 463 par.2 të KPPK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale, është marrë konform nenit 450 të KPPK-së.

Vendimi për programin e kompensimit e viktimave të krimit u muar në kuptim të nenit 39 par.3 pika 1 të ligjit me nr.05/L-036.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN  
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM , DIVIZIONI PENAL**

**2019:163377, 18.02.2021**

**G j y q t a r j a**

---

**Arjeta Gashi**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga koha e pranimin të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.